

VENDIM
Nr. 698, datë 13.11.2024

PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 28 (njëzet e tetë) apartamenteve në 1 (një) ndërtesë me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

GODINA 1D, ZONA E RE ZHVILLIMORE KOMBINAT

Lista e Inventarit të Objekteve Kolektive të Përfunduar në Zonën "Kombinat" (Kohauduar)

Nr.	Objekti	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)	Vlera e studimit projektimit	Vlera e mbikqyrjes së punimeve	Vlera e kohaudimit të punimeve	Vlera e Situacionit të Përfunduar (Ndërtim+Montim)	Vlera Totale (Ndërtim+Studim Projektim+Mbikqyrje+Kohaudim)	Sipërfaqe Total Ndërtimi (Sip. Total Banimi + Sip. Kati Përdhe + Sip. Parkimi + Sip. Taraca) / (m2)	Sipërfaqe Banimi Apartamente (m2)	Sipërfaqe e Njësive të Shërbimit	Sipërfaqja (kat -I)
1	Godina 1D	3	21	4	28	4,647,000	2,176,600	78,500	215,924,991.64	222,827,091.64	4980.90	3405.80	419.3	1,155.8